



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 12

2001

Prill

P Ë R M B A J T J A

Dekret nr.2940
datë 28.3.2001

Për lënie të shtetësisë shqiptare..... 375

Vendim i KM
nr.123, datë 15.3.2001

Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror,
procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të
delegimit të autoritetit të klasifikimit..... 376

D E K R E T
Nr.2940, datë 28.3.2001

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Mihail Petraq Jankulla
2. Christian Mihail Jankulla
3. Shkëlzen Bajram Shala
4. Etleva Bardhyl Mano
5. Kornelia Voltan Mano
6. Leonidha Miltiadh Gjiçali
7. Cris Milto Leonidha Gjiçali
8. Arianita Nicol Leonidha Gjiçali
9. Irma Nikolla Gjiçali (Gjata)
10. Ali Esat Babameto
11. Elizio Ali Babameto
12. Dirk Ali Babameto
13. Esat Ali Babameto
14. Eduard Bego Gaba
15. Suela Rexhep Hahnlein (Shkodra)
16. Xhulion Besnik Isak
17. Doris Kurt Korb (Xhepa)
18. Liliana Muhamer Kume (Çili)
19. Fatmir Qazim Tafa
20. Sokol Sulejman Alia
21. Manjola Abaz Alia (Kameraj)
22. Zyhdi Hamid Demetja
23. Gerald Zyhdi Demetja
24. Naim Enver Shehu
25. Julita Naim Shehu
26. Shirli Naim Shehu
27. Joy Naim Shehu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.123, datë 15.3.2001

**PËR RREGULLAT E PROCESIT TË KLASIFIKIMIT TË SEKRETIT SHTETËROR,
PROCEDURAT QË PËRDOREN PËR IDENTIFIKIMIN E TIJ DHE TË DELEGIMIT TË
AUTORITETIT TË KLASIFIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenve 9 e 31, të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

RREGULLAT E PROCESIT TË KLASIFIKIMIT

Për klasifikimin e informacionit.

1. Të gjitha institucionet shtetërore, të cilat krijojnë (prodhojnë) e administrojnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, të bëjnë klasifikimin e tij, në mbështetje të nenit 6 të ligjit 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”” dhe, në përputhje me të hartojnë listat e dokumenteve të klasifikuara, e cila miratohet nga titullari i ministrisë apo i institucionit që ka autoritetin e klasifikimit origjinal.

2. Pranë çdo institucioni, që ka të drejtën e klasifikimit origjinal, krijohet, me urdhër të titullarit “Komisioni i shqyrtimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror””, me jo më pak se 5 anëtarë, kryetar i të cilit është titullari.

3. Ky komision shqyrton llojet e dokumentacionit që prodhon institucioni dhe propozon atë kategori dokumentesh që duhen klasifikuar, rivlerësuar, nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së këtij niveli.

4. Në përcaktimin e afatit të ruajtjes së informacionit të klasifikuar të merret për bazë pasoja që mund t’i sjellë sigurimit kombëtar.

5. Klasifikimi i informacionit për herë të parë të bëhet për një kohë jo më pak se 10 vjet, për çdo nivel të klasifikimit, me përjashtim të rastit kur autoriteti klasifikuar vendos ndryshe.

6. Për të lehtësuar procesin e klasifikimit origjinal, institucionet, që bëjnë klasifikimin e informacionit, në përputhje me nenin 6 të ligjit, hartojnë listën e dokumenteve të klasifikues, si dhe nivelet e klasifikimit dhe afatet e ruajtjes.

Kjo listë miratohet nga titullari i institucionit.

7. Personat, që administrojnë informacion të klasifikuar, detyrohen të vënë në dijeni titullarin e institucionit 6 muaj para përfundimit të afatit të ruajtjes për riklasifikimin, deklasifikimin ose zhvlerësimin e tij.

8. Rishikimi i afateve të ruajtjes për riklasifikimin, deklasifikimin e zhvlerësimin e këtij informacioni bëhet me urdhër të titullarit të institucionit.

9. Drejtuesit e institucioneve janë të detyruar që, për të gjitha ndryshimet e bëra në gjendjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të njoftojnë DSIK-në dhe institucionin, të cilit i është përcjellë ky informacion.

10. Institucioni që administron informacion të klasifikuar, të transferuar nga një institucion tjetër, zbaton të gjitha procedurat e përcaktuara më lart.

11. Në rastet kur, gjatë administrimit nga personat e autorizuar nga informacioni i klasifikuar, shpëputen pjesë të caktuara, informacioni i përfutur do të ruajë të njëjtin nivel klasifikimi si informacioni i parë.

12. Kur një informacion është i klasifikuar, e gjithë praktika ku bën pjesë ai të klasifikohet në nivelin e këtij informacioni.

13. Kur në një praktikë të informacioneve të klasifikuara, bën pjesë një informacion i klasifikuar në një nivel më të lartë, e gjithë praktika do të marrë nivelin e dokumentit me klasifikim më të lartë.

Për ndalimin e klasifikimit

1. Institucionet shtetërore ndalohen të klasifikojnë informacione të cilat nuk lidhen me sigurimin kombëtar ose me çështje të tjera të përcaktuara në nenin 6 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

2. Çdo shtetas ose punonjës ka të drejtë t’i propozojë titullarit të institucionit deklasifikimin apo riklasifikimin e informacionit, kur autoriteti i klasifikimit origjinal ka klasifikuar apo zhvlerësuar një informacion jashtë kriterëve të ligjit.

3. Drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar i kërkon drejtuesit të institucionit të bëjë deklasifikimin ose zhvlerësimin e këtij informacioni, kur një institucion ka klasifikuar një informacion në kundërshtim me dispozitat e ligjit ose kur informacioni nuk është klasifikuar në nivelin e duhur.

Për propozimin e shtetasve

D. Kërkesa e shtetasve për një informacion që duhet të klasifikohet i drejtohet titullarit të institucionit, i cili, pasi e shqyrton atë nëpërmjet komisionit përkatës, brenda institucionit, vendos nëse duhet të klasifikohet ose jo.

Nëse informacioni nuk klasifikohet, propozuesit i kthehet një përgjigje, ku i shpjegohen shkaqet e moskualifikimit.

II. IDENTIFIKIMI I INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

1. Informacioni i klasifikuar që të identifikohet i tillë nga personat e autorizuar për njohjen e tij apo persona të tjerë, duhet të përmbajë:

- a. stemën e Republikës;
- b. intestimin “Republika e Shqipërisë”;
- c. emërtimin e organit shtetëror dhe të strukturës përkatëse (nëse ka të tillë);
- ç. numrin e regjistrat (protokollit) të korrespondencës;
- d. nivelin e klasifikimit;
- e. afatin e klasifikimit;
- f. vendin dhe datën;
- g. shkurtimin e lëndës;
- gj. adresën e korrespondentit;
- i. numrin e lidhjeve;
- j. emrin dhe mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij;
- k. vulën.

2. Kopja e parë (ekzemplari) i dokumentit ruhet pranë institucionit ku është prodhuar dhe nënshkruhet nga hartuesi, ndërsa kopjet e tjera marrin edhe vulën e institucionit.

Kur korrespondenca kryhet me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Presidencën, Këshillin e Ministrave dhe Gjykatën Kushtetuese, kopja e parë u dërgohet atyre.

3. Dokumentet e brendshme të institucionit kanë të gjitha elementet e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit.

4. Dokumentet e brendshme kur u dërgohen institucioneve të tjera shoqërohen me shkresë përcjellëse, e cila duhet të përmbajë nivelin e klasifikimit të materialit shoqëruar.

5. Kur informacioni i prodhuar nuk është i klasifikuar dhe nuk bën pjesë në kategorinë e informacioneve që i janë nënshtruar procesit të klasifikimit, dhe kur gjykohet se duhet të klasifikohet, prodhuesi i tij, kur e vlerëson të nevojshme, ka të drejtë të propozojë klasifikimin i tij dhe nivelin përkatës.

Deri në dhënien e përgjigjes përfundimtare nga titullari i institucionit, ky informacion nuk do të trajtohet si informacion i zakonshëm.

6. Kur informacioni i prodhuar bën pjesë në një kategori informacionesh të kategorizuara më parë, ai do të klasifikohet në atë nivel.

II. DELEGIMI I AUTORITETIT TË KLASIFIKIMIT

1. Institucionet shtetërore, të cilat prodhojnë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”, detyrohen të paraqesin kërkesë për pajisjen me autorizim për të bërë klasifikimin origjinal.

2. Kërkesa për autoritet klasifikues i drejtohet Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe duhet të përmbajë arsyet përse kërkohet e drejta e klasifikimit origjinal.

3. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar shqyrton kërkesën e paraqitur dhe, kur e gjen të bazuar në ligj e në aktet nënligjore, ia propozon, për miratim, Kryeministrit.

Për rastet kur kjo kërkesë nuk gjendet e bazuar në ligj e në aktet nënligjore, kjo Drejtori i kthen përgjigje institucionit, duke i shpjeguar arsyet e mospranimit, si dhe vë në dijeni Kryeministrin.

4. Kryeministri, kur e gjykon se një institucion shtetëror duhet të ketë të drejtën e klasifikimit origjinal, me nismën e vet ose me propozimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, i lëshon titullarit të institucionit autorizimin për të drejtën e klasifikimit origjinal.

5. Autoriteti i klasifikimit origjinal, në mbështetje të nenit 4 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, mund t’ua delegojë këtë të drejtë, me shkrim, funksionarëve të lartë brenda institucionit për informacionit e nivelit “sekret” dhe “konfidencial”.

6. Për informacionet e nivelit “tepër sekret”, e drejta e klasifikimit nuk mund të delegohet.

7. Në Regjistrin Shtetëror të Informacionit të Klasifikuar, i cili mbahet nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar regjistrohen të gjithë personat e autorizuar për të bërë klasifikimin e informacionit.

IV. RREGULLA TË VEÇANTA

1. Ngarkohen ministritë, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe institucionet shtetërore që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marin masa për klasifikimin e informacionit.

2. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e tjera shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 5.4.2001
Doli nga shtypi më 6.4.2001

Tirazhi: 4200 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta” Tiranë

Çmimi: 50 lekë